

# BURIMI



# I DEMOKRACISË

# INSTITUCIONI MË I LARTË LIGJVËNËS

QËNDRESA (15), AIDA (13), ATLANTI (14), NGADHNJIM (13), VIOLETA (14), ELIONA (13), FORTESA (13)



## Lexues të dashur, nga ne do të mësoni se pse Kuvendi është institucioni më i lartë ligjvënës i një vendi

Kuvendi është institucioni më i lartë ligjvënës i një vendi, sepse ligjet e propozuara në Kuvend votohen nga deputetët dhe më pas vihen në fuqi. Këto ligje që merren në Kuvend kanë rëndësi të madhe në jetën e secilit qytetar. Ligjet për arsim, shëndetësi, infrastrukturë janë vetëm disa prej ligjeve që ndikojnë më së shumti në jetën e ne, nxënësve. Kuvendi ka gjithsej 120 deputetë, prej të cilëve 20 janë nga komunitetet jo shumicë. Për të kaluar një projektligj i caktuar duhet të votohet nga më shumë se 60 deputetë. Të drejtën për të paraqitur projektligje e kanë deputetët, populli, Qeveria dhe Presidenti. Tri funksionet kryesore të Kuvendit janë: funksioni përfaqësues, sepse deputetët përfaqësojnë popullin, funksioni legjislativ, sepse Kuvendi propozon dhe miraton projektligjet, si dhe funk-

sioni kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon Qeverinë, e cila është zbatuese e ligjeve të miratuara në Kuvend. Kuvendi i Kosovës i zbaton parimet e demokracisë, sepse këto parime siç janë: barazia, toleranca, shprehja e lirë e mendimit, votimi, si dhe elemente të tjera, bëjnë që e gjithë udhëheqja e vendit të jetë sa më demokratike. Përveç Kuvendit është edhe populli ai që luan rolin më vendimmarrës në tërë udhëheqjen e vendit. Prandaj, kërkohet që gjithmonë të ketë bashkëpunim të mirëfilltë mes popullit dhe përfaqësuesve që populli i ka zgjedhur. Të ardhmen e vendit e zgjedh vet populli me votat dhe me pjesëmarrjen aktive në të gjitha çështjet që e përcaktojnë zhvillimin intelektual dhe ekonomik të vendit. Mos hezitoni të jeni qytetarë aktiv, sepse idetë e juaja kanë vlerë të madhe në një shtet demokratik dhe vota juaj e ndryshon të ardhmen e Kosovës. Duaje me gjithë zemër shtetin tënd dhe kontribuo për të.



Të gjithë së bashku për demokracinë



Ne e duam zhvillimin e shtetit



Puna në grupe



Intervista në terren




Vota jonë ka vlerë



Duke e shkruajtur artikullin



Elementet e demokracisë



Voto, sepse është përgjegjësi e çdo qytetari

## DEMOKRACIA DJE, SOT DHE NESËR

EGZON (14), RIONA (13), HEROLINDA (13), LENDIANA (13), ALTRESA (14), ALBIN (14)



### Secili ka një zë që meriton të dëgjohet, e demokracia na mundëson që zërat tonë të dëgjohen


Demokracia është një formë e qeverisjes ku populli e udhëheq vendin. Populli e udhëheq vendin përmes votave, duke dalë në zgjedhje dhe duke i votuar përfaqësuesit e vet.

Demokracia ka filluar në Greqi në vitin 507 para erës sonë. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke, ku „demo“ do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Demokracia atë kohë ka qenë më pak e zhvilluar, sepse populli nuk ka pasur të drejta të barabarta dhe ka ekzistuar skllavëria. Tani, gjërat kanë ndryshuar, sepse demokracia ka përparuar. Të gjithë kanë të drejta të barabarta dhe nuk ekziston skllavëria. Në demokraci kemi shumë të drejta dhe përgjegjësi. Disa prej të drejtave themelore të njeriut janë: e drejta e jetesës, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e votimit,

e drejta e shkollimit, e drejta e punës. Ndërsa, disa nga përgjegjësitë janë: pjesëmarrja në zgjedhje, pagimi i taksave, respektimi i rregullave, etj.

Shteti na ka siguruar të drejtën për arsim dhe na ka mundësuar kushtet për arsim, si p.sh. duke ndërtuar shkolla, duke na siguruar mjetet që të zhvillohet mësimi. Po ashtu, paguajnë mësues të ndryshëm që të na përgatisin për jetën, të cilët kanë një rol të rëndësishëm për ne. Shteti na ka mundësuar këto të mira materiale që një ditë kur të arrijmë moshën madhore, këto të mira t'ia kthejmë me punë.

Ka dy forma të demokracisë, është demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli merr pjesë në vendime politike në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kurse, në demokracinë përfaqësuese populli merr pjesë në marrjen e vendimeve, por nëpërmjet përfaqësuesve të tij. Demokracia është e popullit, për popullin dhe nga populli.



Druri i demokracisë



Autorët e artikullit

# VOTA ËSHTË E DREJTË E JONA

EDUARD (14), BETIM (14), LAVDRESA (15), ELDA (13), ARLINDI (13), ENDRINI (14), FLAMURI (14)

**Në shtetin tonë kemi demokraci përfaqësuese dhe për t'i zgjedhur këta përfaqësues, ne duhet të dalim në zgjedhje dhe të votojmë**

Ne nxënësit e klasës VIII-2 nga shkolla fillore „Dëshmorët e Kombit“ patëm nderin dhe mundësinë që sot të jemi gazetarë dhe t'i intervistojmë qytetarët. Ne i pyetëm qytetarët për disa çështje rreth demokracisë dhe lirisë së njeriut në vendin tonë. Pyetjet tona për qytetarët ishin: pse nuk kemi të drejtë të votojmë para moshës 18 vjeçare, si dhe a ekziston barazia gjinore në vendin tonë. Përgjigjet e tyre ishin nga më të larmishmet.

Sa i përket pyetjes për të drejtën së votës, qytetarët thanë se ne ende nuk e kemi arritur pjekurinë e mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin zgjedhor. Kurse për pyetjen rreth barazisë gjinore, disa prej tyre mendonin se në vendin tonë ende nuk ka barazi të plotë gjinore. Ndërsa, disa të tjerë ishin të mendimit se kjo çështje është relative.

Nga kjo punëtori mësuam shumë gjëra si p.sh. mësuam rreth zgjedhjeve lokale dhe atyre qendrore, e gjithashtu kemi bërë aktivitete që ngjallën imagjinatën tonë. Nga këto aktivitete, po ashtu mësuam rreth demokracisë dhe për rëndësinë e saj.

Prej tash, ne si votues të ardhshëm e kemi parasysh se si duhet të votojmë dhe se vota e secilit prej neve është vendimtare për të ardhmen e shtetit tonë.

Ne do ta shfrytëzojmë të drejtën tonë për votim, ashtu siç na e ka ofruar demokracia.




Foto e gazetarëve pas intervistës me qytetarët



Vota është e rëndësishme në demokraci



Në demokraci nuk ka dallime



Votaje të duhurin



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Dëshmorët e  
Kombit“  
Klasa: VIII-2  
Vendi: Kamenicë